



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 308, datë 29.12.2020

**MBI VERIFIKIMIN E PASURISË DHE FIGURËS TË MAGJISTRATIT Z. JULIAN ZONJA, KANDIDAT PËR T'U KOMANDUAR INSPEKTOR PRANË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË**

Bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 159, 184 dhe 189, pika 1, të Ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, neneve 32, 35 dhe 55, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Vendimin nr. 171, datë 27.9.2019, Rregullores "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve", e ndryshuar, si dhe pasi u njoh me Relacionin " Mbi verifikimin e pasurisë, figurës të magjistratit, kandidat për t'u komanduar Inspektor pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, z. Julian Zonja", Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të vlerësojë të përfunduar procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës të kandidatit për t'u komanduar Inspektor pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, z. Julian Zonja, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Lejimin e kandidatit prokuror, z. Julian Zonja dhe vijimin e procedurës së mëtejshme të komandimit si Inspektor pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
3. Të njoftohet për këtë vendim z. Julian Zonja.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR  
GENT IBRAHIMI

ZV/KRYETAR  
ALFRED BALLA

ANËTAR  
KOSTAQ BELURI

ANËTAR  
BUJAR SHESHI

ANËTAR  
NURIHAN SEITI

**ANËTAR  
SANDËR BECI**



**ANËTAR  
VATË STAKA**

**ANËTAR  
ESMERALDA KESHI**



**ANËTAR  
TARTAR BAZAJ**

